



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo • Republic of Kosovo

Institucioni i Avokatit të Popullit  
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Br./No. 692/2017

Nr. i fq./Br. str./Nr. pg. \_\_\_\_\_

Data/Datum/Date: 04/05/17



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

**MENDIM JURIDIK I AVOKATIT TË POPULLIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
NË CILËSINË E MIKUT TË GJYKATËS (AMICUS CURIAE)**

**Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës**

**Ankesa nr.595/2016**

*në lidhje me*

*Paditë ndaj Autoritetit të Likuidimit që janë duke u trajtuar në këtë Gjykatë të paraqitura nga ish-punëtorët e Ndërmarrjes Shoqërore "Sharr Salloniti" nga Hani i Elezit*

Prishtinë, më 4 maj 2017

## Qëllimi

1. Ky mendim juridik në cilësinë e mikut të gjykatës ka për qëllim ofrimin e ndihmës ligjore për krijimin e mundësisë së zgjidhjes efektive të rastit A.nr.595/2016 që ka të bëjë me të drejtat legjitime për dëmshpërblim të ish-punëtorëve të Ndërmarrjes Shoqërore “Sharr Salloniti” nga Hani i Elezit.

## Baza ligjore e veprimit të Avokatit të Popullit

2. Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 132, paragrafi 1: *“Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike”*.
3. Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 135, paragrafi 3: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore”*.
4. Bazuar në nenin 16, paragrafi 9 të Ligjit për Avokatin e Popullit: *“Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi”*.
5. Bazuar në nenin 18 paragrafi 1.6. të Ligjit për Avokatin e Popullit , Avokati i Popullit ka përgjegjësi: *“t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta”*.

## Përshkrimi i rastit

6. Më 11 tetor 2016, Avokati i Popullit, ka pranuar ankesën e z. Bejtush Isufi, avokat, përfaqësues i ish-punëtorëve të Ndërmarrjes Shoqërore “Sharr Salloniti“ nga Hani i Elezit, i cili ankohet në zvarritje të procedurës në ekzekutimin e vendimeve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), për shkak të mungesës së informatave lidhur me paditë e paraqitura në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (Dhoma e Posaçme), ndaj vendimeve të AKP-së.
7. Nga informatat dhe dokumentacioni me të cilat Institucioni i Avokatit të Popullit disponon, rezulton se ish-punëtorët e Ndërmarrjes Shoqërore “Sharr Salloniti“ e cila ka hyrë në procedurë të likuidimit në vitin 2011, kanë paraqitur kërkesat e tyre pranë AKP për kompensim dëmi shëndetësor, të përfituar si pasojë e ekspozimit ndaj asbestit gjatë punës.
8. Ndërmarrja në të cilën kanë punuar këta punëtorë, si aktivitet i saj primar ka qenë puna ndaj të cilës punëtorët i janë ekspozuar detyrimisht dhe pa mbrojtje materialit të rrezikshëm të quajtur *asbest*, ekspozimi ndaj të cilit në ambientin e punës pretendohet të ketë rezultuar në sëmundje profesionale.
9. Autoriteti i Likuidimit pranë AKP-së, ka përfunduar vendimmarrjen lidhur me këtë ndërmarrje dhe bazuar në nenin 41 të shtojcës së Ligjit për AKP-në (Nr. 04/L-034), ka vendosur mbi të gjitha kërkesat në likuidim dhe ka dërguar vendimet tek parashtruesit e kërkesave. Sipas këtij neni, lejohet shpërndarja e fondeve të likuidimit, për përmbushjen e kërkesave të kreditorëve vetëm në kushtet kur ka fonde të mjaftueshme pasi që reduktohet vlera e kërkesave që janë ende të pavendosura në gjykatë. Vendimet e

Autoritetit të Likuidimit lidhur me këto kërkesa janë lëshuar për secilin kërkuar në mënyrë individuale.

10. Meqenëse procedura e likuidimit për këtë ndërmarrje ende nuk ka përfunduar, AKP, në bazë të nenit të cekur më lartë, paragrafi 3 dhe 4<sup>1</sup>, ka të drejtë të bëjë shpërndarjen e pjeshme të fondeve. Kërkesat në fjalë ende nuk janë përmbushur nga AKP, që do të thotë ende nuk janë shpërndarë fondet për kreditorët, pasi që kësaj të fundit i duhet informacion nga Dhoma e Posaçme mbi numrin dhe vlerën e ankesave ndaj vendimeve të Autoritetit të Likuidimit.
11. Më 28 shtator 2016 ankuesi ka pranuar njoftim nga AKP se kjo e fundit ka më shumë se një vit që ka kërkuar zyrtarisht informacion nga Dhoma e Posaçme lidhur me numrin dhe vlerën e ankesave ndaj vendimeve të Autoritetit të Likuidimit, mirëpo ende nuk kanë pranuar përgjigje.

### **Veprimet e Avokatit të Popullit dhe qëndrimet e Dhomës së Posaçme**

12. Më 10 nëntor 2016, Avokati i Popullit i është drejtuar Dhomës së Posaçme, dhe ka kërkuar informacion mbi bazën e procedurës në të cilën ndodhet lënda e lartcekur, dhe gjithashtu ka kërkuar të informohet se çfarë planifikon kjo e fundit, ose tani më ka ndërmarrë, lidhur me këtë lëndë.
13. Më 25 nëntor 2016, Avokati i Popullit ka pranuar përgjigje nga Dhoma e Posaçme, përmes së cilës është informuar se kjo e fundit për çdo lëndë të regjistruar, një kopje ia dërgon AKP-së për të paraqitur përgjigjen e saj si palë e paditur, veprim ky i cili bazohet në nenin 68, paragrafi 8<sup>2</sup> të Ligjit Nr. 04/L-033 për DHPGJSK. Gjithashtu edhe në rastet kur AKP ka parashtruar kërkesa për lëndët në procedurë, Dhoma e Posaçme ka deklaruar se ka dhënë informacion pa vonesë. Por në anën tjetër, përmes kësaj përgjigje, gjykata ka pohuar se pranë saj janë duke u trajtuar ankesat/paditë e 460 ndërmarrjeve shoqërore dhe nuk mund të vlerësojnë saktësisht kohën e procesimit të tyre, por do të trajtohen sipas viteve dhe prioriteteve. Gjithashtu, gjykata ka njoftuar se nuk mund të bëjnë klasifikime të ndërmarrjeve, duke ditur që Autoriteti i Likuidimit ka lëshuar vendime në mënyrë individuale, andaj lëndët do të shqyrtohen sipas ankesave dhe padive të parashtruesve.

### **Analiza ligjore dhe konstatimet e Avokatit të Popullit**

14. Vlerësimet dhe konstatimet e Avokatit të Popullit, lidhur me këtë çështje bazohen në të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (Kushtetuta), Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollin e saj (KEDNJ), dhe praktiken e Gjykatës Evropiane për të Drejtat Njeriut (GJEDNJ).
15. Sipas Kushtetutës, neni 22, (2), të drejtat dhe liritë e njeriut janë të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, në veçanti me KEDNJ, e cila sipas kësaj dispozite është drejtpërdrejtë e zbatueshme në Kosovë dhe ka prioritet në rast konflikti ndaj dispozitave dhe akteve të tjera të institucioneve publike.

---

<sup>1</sup> Nenin 41 i shtojcës së Ligjit për AKP-në (Nr. 04/L-034) paragrafi 3 dhe 4: " Nëse resurset janë të mjaftueshme për të përmbushur të gjitha kërkesat e një kategorie të caktuar, duke përfshirë mbulimin për rezervimet e bëra nga Autoriteti i Likuidimit për kërkesat e kontestuara të një kategorie apo renditje, Autoriteti i Likuidimit mund të propozojë shpërndarjen e përkohshme në këto kategori të kreditorëve para Bordit. 4. Nëse resurset janë të pamjaftueshme për të përmbushur tërësisht të gjitha Kërkesat apo interesat e një kategorie apo niveli të caktuar, përfshirë mbulimin për rezervimet e Autoritetit të Likuidimit për kërkesat e kontestuara të një kategorie apo niveli, Kërkesat e asaj kategorie apo niveli përmbushen në proporcion me shumën e çdo Kërkesë, përfshirë kërkesat për të cilat Autoriteti i Likuidimit ka bërë rezervime".

<sup>2</sup> Neni 68, paragrafi 8 i Ligjit për DHPGJSK "Një kopje e ankesës do t'i dorëzohet Agjencisë nga Regjistër mbajtësi i Dhomës së Posaçme brenda pesë (5) ditëve të punës pasi që të jetë parashtruar në Dhomën e Posaçme".

16. Neni 53, i Kushtetutës përcakton se të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të GJEDNJ.
17. Neni 21 i Kushtetutës garanton se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.
18. Asbesti tanimë është i njohur botërisht si element i dëmshëm për shëndetin. Organizata Botërore e Shëndetësisë ka vlerësuar se ekspozimi ndaj këtij materiali është një nga elementet kryesorë për shkaktimin e sëmundjeve profesionale.<sup>3</sup> Pas këtij konstatimi, në nivel global janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për mbrojtje të punëtorëve nga ekspozimi ndaj tij, gjithashtu është shtuar kujdesi dhe janë vendosur rregullat për përdorimin të tij në industri. Një numër i madh shtetesh kanë miratuar legjislacion të posaçëm për parandalimin e shkaktimit të dëmeve shëndetësore nga ky material duke përfshirë edhe kriteret për dëmshpërblimin e punonjësve të dëmtuar në këtë fushë. Në Kosovë nuk është e rregulluar me legjislacion specifik kjo problematikë, gjithashtu as edhe mënyra e dëmshpërblimit të atyre të cilët janë prekur nga kjo dukuri.
19. Më 24 korrik, GJEDNJ shpalli gjykimin e saj në çështjen Brincat dhe të tjerët kundër Maltës (çështja Brincat).<sup>4</sup> Ky rast ishte rezultat i 21 aplikimeve të ish-punëtorëve të portit për riparimin e anijeve publike të ekspozuar ndaj asbestit. Qeveria e Maltës ishte përgjegjëse për shkeljen e detyrimeve pozitive për të mbrojtur të drejtën për jetë dhe të drejtën për respektimin e jetës private. Një shkelje e së drejtës për jetë u gjet kur vdekja e punonjësit ishte rezultat i ekspozimit ndaj asbestit. Aty ku punonjësit kishin vuajtur nga sëmundje të ndryshme, Gjykata gjeti shkelje të së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare.
20. Ndërmarrja Shoqërore “Sharr Salloniti” nga Hani i Elezit, pjesë e kombinatit “SHARR”, e cila ka vepruar nga viti 1974, si aktivitet kryesor kishte punën me materialin asbest. Studimi ambiental mbi ndotjen nga asbesti, i financuar nga Agjencia Evropiane për Rindërtim, më 29 mars 2001, ka përcaktuar prezencë të pluhurit të asbestit në ambientet e fabrikës, duke rekomanduar edhe masa mbrojtëse për mbrojtjen e punëtorëve ndaj ekspozimit. Ish-punëtorët e kësaj ndërmarrje kanë punuar me vite të tëra pranë saj. Autoriteti i Likuidimit, bazuar në provat lidhur me këtë çështje ka konstatuar se ekspozimi i ish-punëtorëve ndaj asbestit ka ndodhur.<sup>5</sup> Ndërmarrja, për arsyet e cekura më lartë, me një vendim të veçantë është mbyllur nga UNMIK-u, dhe nga viti 2011 ka hyrë në procedurë likuidimi.
21. Që nga atëherë është konstatuar se kanë vdekur rreth 100 ish-punëtorë të ndërmarrjes “Sharr Salloniti”, dhe të tjerët janë duke i vuajtur pasojat shëndetësore të shkaktuara nga ekspozimi i pambrojtur i tij.<sup>6</sup>
22. Avokati i Popullit, duke u bazuar në analizën procesit të deritanishëm të rastit konsideron se kemi të bëjmë me ngecje të procedurave administrative, për përmbushjen e të drejtave legjitime ndaj palëve. Sipas informatave në dispozicion kjo procedurë është stopuar për faktin se Dhoma e Posaçme nuk i ka ofruar AKP-së numrin dhe vlerën e ankesave ndaj vendimeve të kësaj të fundit, që do të hapte rrugën për zgjidhjen e mundshme të

<sup>3</sup> Health World Organization, “Asbestos: elimination of asbestos-related diseases”, <http://www.who.int/mediacentre/factsheets/fs343/en/>.

<sup>4</sup> GJEDNJ, Brincat dhe të tjerët v Maltës (60908/11, 62110/11, 62129/11, 62312/11, 62338/11), 24 korrik 2014.

<sup>5</sup> Agjencia Kosovare e Privatizimit, Vendim, 27.10.2014, lidhur me kërkesën e S.D. për dëmshpërblim, për shkak të përfitimit të sëmundjes profesionale nga ekspozimi ndaj asbestit.

<sup>6</sup> Po aty.

problemit. Sipas një formule të përgjithshme të GJEDNJ që zbatohet si për detyrimet pozitive ashtu edhe për ato negative thotë: “një pengesë reale (faktike) mund të përbëjë shkelje të Konventës po aq sa dhe një pengesë juridike”.<sup>7</sup>

23. Rrjedhimisht, kërkesa e AKP për Dhomën e Posaçme është konkretisht e aspektit teknik. Sipas nenit 5 të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme, paragrafi 3: “Çdo person mund ta konsultojë regjistrin në Zyrën e regjistrimit dhe mund të marrë kopje të ekstrakteve të regjistrit, me përjashtim të dokumenteve të cilat janë shpallur konfidenciale me urdhër të nxjerrë nga Dhoma e Posaçme pas pagesës së një shume të cilën e cakton Presidiumi”. Ndërsa paragrafi 4 përcakton se “Zyra e regjistrimit të Dhomës së Posaçme mund të kërkojë ndihmë nga cilado gjykatë tjetër në Kosovë dhe ajo ndihmë i ofrohet, me qëllim të përmbushjes së detyrave të veta”.
24. Për t’i përmbushur të drejtat legjitime ndaj palëve, AKP-së përveç se i duhet informacion mbi numrin e ankesave drejtuar Dhomës së Posaçme, asaj i duhet edhe vlera e tyre, që konform nenit 40 dhe 41 i shtojcës së Ligjit për AKP-në, (Nr. 04/L-034), të vlerësohet mundësia e pagesës, pasi të reduktohet vlera e kërkesave që janë ende të pavendosura në gjykatë.
25. Avokati i Popullit shpreh shqetësimin lidhur me kohëzgjatjen procedurale për zgjidhjen e këtij rasti, pasi kemi të bëjmë me një kategori shumë të ndjeshme të palëve të cilët, siç është elaboruar më lartë, janë duke u ballafaquar me pasoja të rënda shëndetësore, shumica prej tyre janë diagnostifikuar me sëmundjen e kancerit dhe pjesa tjetër po i vuajnë dëmet e tjera shëndetësore. Është edhe më shqetësues fakti se fondet të cilat po i presin këta ish-punëtorë, ato do t’iu shërbejnë për kurimin e mëtutjeshëm të shëndetit. Vlen të përmendet rasti *Brincat dhe të tjerët v. Malta*, ku GJEDNJ ka gjetur shkelje të nenit 2 të Konventës. Gjykata konstatoi se dështimi për të mbrojtur dhe informuar individët lidhur me rreziqet mjedisore që përfshinte asbestin, cenoi të drejtën për të jetuar.
26. Avokati i Popullit u referohet parimeve të përgjithshme të paraqitura në praktikën gjyqësore të GJEDNJ, lidhur me nenin 2, “ku jetët janë humbur në rrethana që potencialisht përfshijnë përgjegjësinë e shtetit, ajo dispozitë përfshin një detyrë që shteti të sigurojë, me të gjitha mjetet në dispozicion të vet, një përgjigje adekuate-gjyqësore apo ndryshe-ashtu që korniza legjislative dhe administrative e krijuar për të mbrojtur të drejtën në jetë të implementohet si duhet dhe çdo shkelje e asaj të drejte të ndalet dhe dënohet” (shih, GJEDNJ, *Budayeva dhe të tjerët kundër Ruisisë*, në § 140; GJEDNJ, *Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar*, në § 115; dhe GJEDNJ, *Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, në § 54).
27. Sa i përket ankesave kundër vendimeve të Autoritetit të Likuidimit, të paraqitura pranë Dhomës së Posaçme nga ish-punëtorët e ndërmarrjes “Sharr-Salloniti”, të paraqitura nga viti 2014, konsiderojmë se kemi të bëjmë me zvarritje procedurale, për shkak se nga koha e paraqitjes, ende nuk i janë nënshtruar procedurës së trajtimit. Avokati i Popullit, më 31 janar 2017, ka publikuar raportin me rekomandime në lidhje me zvarritjet procedurale në trajtimin e lëndëve nga Dhoma e Posaçme,<sup>8</sup> dhe në bazë të hetimit të çështjes gjithashtu përgjigjes nga Dhoma e Posaçme, jemi informuar që lëndët janë duke u trajtuar sipas strategjisë së hartuar nga kjo e fundit për zgjidhjen e rasteve të grumbulluara. Andaj, konsiderojmë se është shqetësues fakti nëse lëndët e këtyre palëve do të trajtohen në të njëjtën mënyrë me të tjerat, duke e ditur se lëndët pranë Dhomës së

<sup>7</sup> GJEDNJ, *Airey c. Irlande*, 11 shtator 1979.

<sup>8</sup> IAP, Raport me rekomandime, Ex- officio, nr.44/2017, gjindet në:

[http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/44-2017\\_Raport\\_me\\_rekomandime\\_907377.pdf](http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/44-2017_Raport_me_rekomandime_907377.pdf).

Posaçme janë duke u trajtuar me zvarritje të tejzgjatur procedurale, dhe në rastin konkret pasi kemi të bëjmë me një kategori të ndjeshme të palëve, me komplikime shëndetësore, ekziston një pikëpyetje nëse të gjithë mund t'i jetësojnë këto vendime. *Sylvester kundër Austrisë*, GJEDNJ, aktgjykimi 3 shkurtit 2005, paragrafi 32 thotë: “Gjykata ka ripërsëritur se, në rastet që kanë të bëjnë me statusin shoqëror, kërkohet përkushtim i veçantë në kuptim të pasojave të mundshme që mund të shkaktojë kohëzgjatja e madhe e procedurës, shprehimisht në gëzimin e të drejtës për respektimin e jetës familjare [...]”. Në rastin *X v. France* (31 mars 1992), GJEDNJ trajton çështjen e “përkushtimit të veçantë” që do të duhej ta aplikojnë gjykatat kombëtare në rastet kur palët vuajnë nga sëmundje të pashërueshme.

28. Gjithashtu, Avokati i Popullit shpreh shqetësimin nëse këto lëndë, meqë janë të natyrës së njëjtë, do të trajtohen në mënyrë individuale nga Dhoma e Posaçme. Kjo do të shkaktoje kohëzgjatje të paarsyeshme procedurale deri në zgjidhjen e tyre. Shtojca e Ligjit për Dhomën e Posaçme, Nr.04/L-33, neni 33, paragrafi 1, përcakton: “Kurdoherë gjatë procedurave, Dhoma e Posaçme mund të urdhërojë bashkimin e dy apo më shumë kërkesave/ankesave që kanë të bëjnë me të njëjtën çështje për qëllim të procedurave me shkrim apo me gojë ose të Aktgjykimit. Para nxjerrjes së një Aktgjykimi për të gjitha kërkesat/ankesat që do të bashkohen, mund të ndahet çfarëdo kërkesë/ankesë për të cilën nuk është nxjerrë një Aktgjykim”. Në vitin 2006, Dhoma e Posaçme ka nxjerrë Aktgjykimin RE: SCEL-05-009, rasti Radomir Milutinovic (Punëtorët e Lamkos-it) kundër KTA. Gjatë trajtimit të këtij rasti Dhoma e Posaçme i ka bashkuar të gjitha ankesat për të njëjtën çështje, dhe ka vendosur për të gjitha në një aktgjykim. Meqë, ankesat e ish-punëtorëve “Sharr Salloniti” janë të natyrës së njëjtë, konkludojmë se Dhoma e Posaçme duhet ndjekur të njëjtën praktikë si në aktgjykimin e sipërpërmendur. Autoritetet kanë obligim pozitiv “për të organizuar sistemet e tyre të drejtësisë në atë mënyrë që gjykatat e tyre mund të plotësojnë të gjitha kushtet e tyre, përfshirë edhe obligimin për t'i dëgjuar rastet brenda kohës së arsyeshme”.<sup>9</sup> Ky detyrim ekziston pa marr parasysh shpenzimet.<sup>10</sup>
29. Rikujtojmë se standardet e të drejtave të njeriut kanë për qëllim të garantojnë jo të drejta teorike dhe të paarritshme, por të drejtat që janë “praktike dhe efektive”.<sup>11</sup> Për sa i përket gjykatave ndërkombëtare, pohimi i thjeshtë i ekzistencës së të drejtave apo ligjeve, që i mbrojnë të drejtat teorikisht ose vetëm formalisht, nuk mjafton për të përmbushur testin e “prakticitetit dhe efektivitetit” të këtyre të drejtave.
30. Avokati i Popullit konsideron se mohimi i të drejtës për përmbushjen e të drejtave legjitime dhe zvarritja procedurale gjyqësore, shkaktojnë shkelje të së drejtës për zgjidhje efektive, e drejtë kjo e garantuar me nenin 13 të KEDNJ, dhe shkelje të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, e garantuar me nenin 6 të KEDNJ.
31. Rikujtojmë se detyrimet pozitive rrjedhin nga detyrat për mbrojtjen e individëve që ndodhen nën juridiksionin e një shteti. Detyrimi për të siguruar praktikitetin dhe efektivitetin e të drejtave është i lidhur drejtpërdrejt me të drejtën për zgjidhje efektive dhe sundimin e ligjit.

<sup>9</sup> *Süssmann kundër Gjermanisë*, GJEDNJ, aktgjykimi 16 shtatorit 1996, paragrafi 55. Për më tepër, autoritetet mund të mbahen përgjegjëse jo vetëm për çfarëdo vonese në trajtimin e një rasti të veçantë në operimin e një sistemi përgjithësisht të shpejtë për administrimin e drejtësisë, por po ashtu edhe për dështimin për të rritur resurset në përgjigje ndaj mbingarkesës me lëndë dhe për mangësi strukturore në sistemin e vet të drejtësisë që shkaktojnë vonesa. Shih Harris, O'Boyle & Warbrick. *Law of the European Convention on Human Rights, edicioni i dytë*, Oxford University Press, 2009, faqet 278-284.

<sup>10</sup> *Airey kundër Irlandës*, GJEDNJ, aktgjykimi i 9 tetorit 1979, paragrafi 20.

<sup>11</sup> Ky parim është miratuar nga Komiteti i të Drejtave të Njeriut, OKB, Doc.CCPR/C/21/Rev.1/Add/13 (2004).

## KONKLUZION

- 1. Për arsyet e lartpërmendura, konsiderojmë se do të ishte e përshtatshme që Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme në rastin konkret duhet të tregoj praktikitet efektiv për zgjidhjen e rastit të ish-punëtorëve të ndërmarrjes “Sharr Salloniti”, duke i dërguar informacion specifik AKP-së, lidhur me numrin dhe vlerën e ankesave të paraqitura kundër vendimeve të Autoritetit të Likuidimit.*
- 2. Për të parandaluar vonesat e mëtutjeshme në trajtimin e lëndëve të paraqitura nga këta ish-punëtorë pranë Dhomës së Posaçme, kjo e fundit do të duhej të praktikojë bashkimin e lëndëve për çështje të njëjta, t’i trajtojë ato bashkërisht me një aktgjykim.*
- 3. Për shkak të ndjeshmërisë së rastit, duke marrë parasysh aspektin moral dhe njerëzor, të tregojë prioritet ndaj trajtimit të këtyre lëndëve duke mënjanuar pengesat strukturore që do të shkaktonin vonesa, dhe gjithashtu t’i kushtohet vëmendje e posaçme praktikës së GJEDNJ-së, për zgjidhjen efektive të tyre.*

Me nderime,

  
Hilmi Jashari

Avokat i Populli